

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.19.08.2023*

**19.08.2023
Ora 12:05**

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarët dhe sekretarin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor nr. 11 për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ:**
 - **Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**
 - **Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja, Z. B. Kodra**
- **Parti Politike: PD (Z. Rezart Kthupi)**
- **Të tjerë:**

Z. I. Celibashi: Mirëdita! Në seancën e sotme kemi në rend dite:


Projektvendimin që lidhet me “Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarët dhe sekretarin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor nr. 11, për zgjedhjet e pjesshme vendore për Kryetarin e Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023”.

Pika 2. Projektvendimi “Për miratimin e formatit dhe specifikimeve të vulës së KZAZ-së, KQV-së, Kryetarit të KQV-së dhe vulës rezervë për KQV-në, për zgjedhjet për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023” dhe,

Pika 3. Projektvendimi “Për shpërblimin e anëtarëve të Komisioneve Zgjedhore të ZAZ-së nr. 11, të angazhuara në zgjedhjet e pjesshme për Kryetarin e Bashkisë Kukës, të datës 24.9.2023”.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.19.08.2023*

Z. Y. Merkaç: Kodi Zgjedhor në nenin 19, pika 1, shkronjat “a” dhe “b”, përcakton se anëtarët e KZAZ-së, emërohen nga KQZ sipas kësaj procedure:

- dy anëtarë propozohen nga partia kryesore e shumicës parlamentare, dy anëtarë propozohen nga partia kryesore e opozitës parlamentare, një anëtar propozohet nga partia e dytë e shumicës parlamentare dhe një anëtar propozohet nga partia e dytë e opozitës parlamentare.

- Në rast se nuk arrihet barazpeshimi politik, grupi përkatës kompensohet me kandidaturat e partisë kryesore deri në barazpeshimin politik shumicë-opozitë.

- Anëtari i shtatë propozohet në gjysmën e KZAZ-ve nga partia e parë e shumicës parlamentare, kurse në gjysmën tjetër nga partia e parë e opozitës parlamentare. Bazuar në përcaktimet e nenit 29, pika 4, të Kodit Zgjedhor, në zgjedhjet vendore, renditja përcaktohet mbi bazën e numrit të votave të fituara në shkallë vendi për këshillat vendorë në zgjedhjet pararendëse nga partitë parlamentare. Bazuar në vendimin nr. 27, datë 7.8.2023, të Komisionit Rregullator, “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”, bazuar në rezultatin e numrit të votave të fituara në shkallë vendi për këshillat vendorë, subjektet zgjedhore janë renditur si vijon:

1. Partia Socialiste e Shqipërisë, ka fituar 43,11%;
2. Koalicioni Bashkë Fitojmë, ka fituar 18,44%
3. Partia Demokratike, ka fituar 7,71%
4. Partia Socialdemokrate, ka fituar 6,42%

Gjithashtu, referuar shkresës së Kuvendit të Shqipërisë, partitë parlamentare janë si vijon:


Shumica parlamentare

1. Partia Socialiste e Shqipërisë: 74 mandate në Kuvendin e Shqipërisë;

Pakica parlamentare:

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.19.08.2023*


1. Partia Demokratike e Shqipërisë “Aleanca për Ndryshim”: 59 mandate në Kuvendin e Shqipërisë
2. Lëvizja Socialiste për Integrim: 4 mandate në Kuvendin e Shqipërisë;
3. Partia Socialdemokrate: 3 mandate në Kuvendin e Shqipërisë.

Në analizë të dispozitave të Kodit Zgjedhor, rezultati përfundimtar të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023 dhe të shkresës së Kuvendit të Shqipërisë arsyetohet si vijon: - Neni 29, pika 4, fjalia e dytë, i Kodit Zgjedhor, përcakton qartë procedurën që ndiqet për caktimin e partive që kanë të drejtë të propozojnë anëtarët e KZAZ-ve. Në zgjedhjet vendore, renditja përcaktohet mbi bazën e numrit të votave të fituara në shkallë vendi për këshillat vendore në zgjedhjet pararendëse nga partitë parlamentare. Që një parti të gëzojë të drejtën për të propozuar kandidat për KZAZ, duhet të plotësojë 2 kushte, së pari të ketë marrë pjesë në zgjedhjet pararendëse për organet e pushtetit vendor dhe së dyti, të jetë parti parlamentare. Sipas kësaj procedure:

- Dy anëtarë të KZAZ-së propozohen nga partia kryesore e shumicës parlamentare e cila është Partia Socialiste.
- Dy anëtarë të KZAZ-së i propozon partia kryesore e opozitës parlamentare, që është Partia e Lirisë. Pasi në zgjedhjet vendore të datës 14 maj 2023, Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, bazuar në dokumentacionin e kandidimit ka deklaruar Partinë e Lirisë si parti udhëheqëse të koalicionit. Në bazë dhe në zbatim të nenit 65 të Kodit Zgjedhor, të gjitha të drejtat dhe detyrimet që përcakton ky ligj për subjektet zgjedhore përmbushen nga partia udhëheqëse e koalicionit. Në përfundim duke parë dhe barazpeshimin dhe konfigurimin e shumicës parlamentare tre anëtarë propozohen nga Partia Socialiste për KZAZ-në nr.11, dy anëtarë do të propozohen nga Partia e Lirisë për KZAZ-në nr.11, ndërsa anëtari i tretë i opozitës parlamentare, propozohet nga Partia Demokratike. Për përcaktimin e anëtarit të shtatë të KZAZ-

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.19.08.2023*

së, do të ndiqet procedura e vendimit nr. 5, neni 4 i Komisionit Rregullator, i cili përcakton rregullat për organizimin e KZAZ-së, ku përcakton dhe procedurën e shortit. Kemi procedurën e shortit dhe të parashortit. Në një enë janë vendosur partitë që marrin pjesë në short, konkretisht Partia e Lirisë dhe Partia Socialiste. Në enën e dytë janë vendosur dy gogla me shiritat e letrës “numri çift” dhe “numri tek”. Anëtari që do të tërheqë goglën e shkruar “numri tek” tek ena e dytë do të ketë të drejtën të përcaktojë anëtarin e shtatë të KZAZ-së nr.11. Për këtë kemi përgatitur dy enët transparente për procedurën e shortit.

Z. I. Celibashi: Përfaqësuesit e partive? Po!

Z. R. Kthupi, përfaqësues i PD-së: Ajo që ne vëmë re në vendim është që ka një interpretim ligjor bazuar në dy momente juridike. E para është neni 29, pika 4 dhe e dyta është neni 65, pika 3. Pika 4 e nenit 29, Komisioner, referon shprehimisht në partinë politike, që do të thotë se të gjitha tagrat që lidhen me caktimin e anëtarit të KZAZ-së, janë specifikisht të partisë politike. Ajo që ndodh është se nëpërmjet interpretimit të pikës 3, të nenit 65 bëhet barazimi i subjektit zgjedhor me partinë politike. Tani neni 65, pika 3 përcakton që partia udhëheqëse e koalicionit ushtron tagrat e subjektit zgjedhor dhe jo tagrat e partisë politike. Nuk mund të jemi në asnjë rast në kushtet ku barazohet subjekti zgjedhor me partinë politike. Kjo për arsye të shumta. Duke filluar nga fakti që subjekti zgjedhor është një subjekt që fiton personalitet, nëse ka, sepse kjo është një pyetje shtesë, fiton personalitet në momentin që regjistrohet si subjekt zgjedhor në KQZ. Jemi në kushtet ku subjekti zgjedhor “Bashkë Fitojmë” është subjekt zgjedhor që është regjistruar për zgjedhjet vendore të 14 majit. Ky subjekt zgjedhor vazhdon personalitet politik, le të themi elektorale pas përfundimit të rezultatit të zgjedhjeve që është e para. E dyta, kodi nuk


*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.19.08.2023*

ka asnjë pikë në të cilën barazon subjektin zgjedhor me partinë politike dhe asnjë pikë ku i jep partisë udhëheqëse të koalicionit tagra për të përfituar ato që do të ishin të drejta që i ka ekskluzivisht partia politike. E vetmja referencë që mund të gjendet për krahasim dhe analogji është neni 88 i kodit. Është pika, 3 ku është rasti që KQZ-ja shpërndan fondet paszgjedhore. Me këtë rast KQZ-ja nuk ja njuh partisë drejtuese të koalicionit fondet zgjedhore, por bën një përlllogaritje në bazë të mandateve të fituara dhe mesatares së votave për çdo mandat. Kjo do të thotë që kodi në logjikën e tij dhe kur i ka njohur partisë udhëheqëse të koalicionit tagra, apo të drejta, i ka për aq kohë sa jemi brenda fushatës zgjedhore, që do të thotë se i njihen tagra si subjekt zgjedhor. Formulimi i nenit 65, fjalia e fundit është: “për nevojat e zbatimit të këtij ligji, të gjitha të drejtat dhe detyrimet që ky ligj përcakton për subjektin zgjedhor...”. kjo do të thotë jo për partinë politike, por për subjektin zgjedhor si subjekt, “...përmbushen nga partia udhëheqëse e koalicionit”. Nqs do t’i referohemi nenit 29, pika 4 thotë: “Renditja e partive për efekt të ndarjes së vendeve në KZAZ, sipas përcaktimeve të këtij neni, bëhet mbi bazën e numrit të mandateve që ka fituar partia politike..” dhe në këtë rast administrata ka vendosur të bëjë një barazim ndërmjet subjektit zgjedhor dhe partisë politike që na çon në përlllogaritjen e shumës së votave të marra nga Kolicioni “Bashkë Fitojmë”, si vota të marra nga Partia e Lirisë. Kjo e para punës zoti Komisioner, deformon komplet logjikën e ligjit, sepse partia politike është një subjekt juridik e regjistruar që ushtron veprimtari të vazhdueshme në KQZ. Ndërkohë që një koalicion ushtron veprimtari për aq kohë sa jemi në fushatë zgjedhore. Në momentin që kjo fushatë mbaron, nuk mund të ketë më tagra përfaqësimi në KQZ. Vullneti politik i palëve do të ishte në qoftë se do të kishim një rast. Nëse marrëveshja e koalicionit do të shtrinte efekte dhe mbi të drejtat që partitë politike përfitojnë pas fushatës zgjedhore. Nëse i referohemi marrëveshjes së depozituar në KQZ nga Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, nuk ka asnjë përcaktim në

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.19.08.2023*

lidhje me tagrat që një parti udhëheqëse e koalicionit, përveç tagrave të parashikuara nga neni 65, i ka krahasimisht me partitë e tjera. Në këto kushte, unë gjykoj se është ligjërisht jo e bazuar, interpretimi që bëhet duke barazuar subjektin zgjedhor me partinë politike dhe duke i njohur Partisë së Lirisë të drejtën mbi caktimin e komisionerëve, sipas nenit 29.

Z. I. Celibashi: Po, faleminderit! Atëherë, sipas pretendimit tuaj, ne biem dakord që përcaktimi i partive politike, të cilat kanë të drejtën për të propozuar anëtarë të KZAZ-së për zgjedhjet e datës 24 shtator në Kukës do të bazohet në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve të datës 14 maj. Specifikisht në numrin e votave të marra për këshillat. Këtu jemi dakord?

Z. R. Kthupi, përfaqësues i PD-së: Shumë dakord!

Z. I. Celibashi: Konsiderata juaj ka të bëjë thjesht me faktin që në rastin e koalicionit, ky rezultat nuk duhet të llogaritet për efekt ushtrimi të të drejtës, ose të posedimit të së drejtës për të propozuar anëtarë të KZAZ-së. Me pak fjalë, ju jeni duke thënë “edhe pse Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, ka marrë numër votash i dyti në rradhë pas Partisë Socialiste, 18.44 %, ju thoni që këtij koalicioni dhe asnjë prej partive përbërëse të këtij koalicioni nuk i takon e drejta për të propozuar anëtarë të KZAZ-së. Kështu e kuptova?

Z. R. Kthupi, përfaqësues i PD-së: Jo në këtë formë!

Z. I. Celibashi: Të lutem!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.19.08.2023*

Z. R. Kthupi, përfaqësues i PD-së: Logjika është e tillë. Unë nuk e kam me tagrin që ka koalicioni të caktojë komisionerë. Në logjikën e partisë së dytë, të partisë parlamentare, unë jam shumë dakord që Partia e Lirisë të caktojë komisionerë. Çështja është që raporti ndërmjet numrit të komisionerëve që caktohen është bazuar mbi numrin e votave që subjektet marrin në procesin zgjedhor. Në këto kushte, ajo që kundërshtoj është që Partia e Lirisë nuk mund të bazohet në totalin e votave të koalicionit. Kjo për një arsye shumë të thjeshtë, zoti Komisioner. Kam një pyetje që sot ja adresoj KQZ-së. Sot që flasim, Koalicioni “Bashkë Fitojmë” është regjistruar subjekt në zgjedhjet vendore të 24 shtatorit? Në rastin konkret po i japim tagra një pjesëmarrësi, një koalicioni që nuk e dimë nëse do të jetë, apo jo i reflektuar në zgjedhje. Çështja është që në logjikën që ndjek KQZ-ja në mënyrën e interpretimit të ligjit bën një barazim midis tagrave që fiton subjekti zgjedhor për shkak të pjesëmarrjes në zgjedhje dhe tagrave që fiton një parti politike. Në rast se do të interpretonim për analogji nenin 88, do të ishim të detyruar të bënim një përllogaritje të mandateve që ka fituar Partia e Lirisë brenda koalicionit. Sipas këtyre mandateve të bënit një përllogaritje të numrit të votave të krahasonit pastaj nëse ky numër votash është më i madh se numri i votave të fituara nga Partia Demokratike, apo është më i vogël? Ky krahasim do të na nxirrte pastaj në logjikën e partisë së parë opozitare që ka të drejtën e caktimit të një apo dy komisionerëve në KZAZ.

Z. I. Celibashi: Po, pra shumë e qartë! Argumenti juaj është me sens, nuk është se është pa sens. Edhe nuk ka vend që të diskutohet dhe debatohet, por për të arritur në një kuptim, ndoshta të përbashkët, ajo që unë dua të kuptoj prej jush është që.. dhe më duket se e thatë pak a shumë... Ju nuk jeni kundër, pra nuk e injoroni faktin që ai si koalicion qëndron i dyti në rradhë të numrit të votave që ka marrë për anëtarë të këshillit.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.19.08.2023*

Z. R. Kthupi, përfaqësues i PD-së: Absurditet!

Z. I. Celibashi: Po! Nuk jeni duke thënë që nuk do të duhet të konsiderohet rezultati i koalicionit dhe rrjedhimisht do të duhet të konsiderohet rezultati i Partisë Demokratike, e cila është e treta në rradhë. Nuk jeni duke thënë këtë?

Z. R. Kthupi, përfaqësues i PD-së: Ta theksoj dhe njëherë! Çështja është për të arritur në përfundimin dhe unë që e shtroj si çështje nuk jam në gjendje të them nëse Partia Demokratike ka më shumë vota se Partia e Lirisë, sot...

Z. I. Celibashi: Jo, nuk po themi këtë! Edhe njëherë! Ju jeni dakord që të mos përjashtohet në vlerësim rezultati i Koalicionit “Bashkë Fitojmë”?

Z. R. Kthupi, përfaqësues i PD-së: Shumë dakord!

Z. I. Celibashi: Nëse themi këtë. Do të thotë që këtë rezultat ne duhet ta konsiderojmë dhe ky rezultat e bën këtë koalicion të dytin në renditje.


Z. R. Kthupi, përfaqësues i PD-së: Shumë dakord!

Z. I. Celibashi: Pra i gjithë diskutimi është nëse këtë të drejtë e ka Partia e Lirisë, apo nuk e ka Partia e Lirisë?

Z. R. Kthupi, përfaqësues i PD-së: Në tërësinë e votave të koalicionit.

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.19.08.2023*

Z. I. Celibashi: Po, pra! Tani këtë koalicion o e përfaqësojnë të dyja së bashku, ose koalicionin e përfaqëson secila prej partive anëtare të koalicionit, logjikisht kjo! Sa kohë që ligji, ashtu sikurse dhe ju e thoni, kësaj çështje nuk i ka bërë një rregullim të qartë, do të duhet të bëjmë një interpretim logjik. Interpretimi logjik, mendoj unë qëndron sipas draftit të paraqitur, sepse nuk kemi alternativë tjetër. Përndryshe do të duhet të injorojmë të drejtën e këtij subjekti, nuk po i them as zgjedhor, as politik për të propozuar anëtarë të KZAZ-së. Edhe një herë, o do ta ketë Partia e Lirisë, o do ta ketë Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut, nëse nuk gaboj që ka qenë anëtare e këtij koalicioni, ose Partia Demokristiane, ose të treja së bashku. Argumenti tjetër që ne nuk e dimë nëse ky koalicion do të regjistrohet, por dhe nëse do të regjistrohet, ai nuk ka të drejtën si person juridik. Ai mund të regjistrohet me të njëjtin emër, koalicion, por nuk është i njëjti koalicion në kuptim të personit juridik. Nuk kemi zgjidhje tjetër mendoj. Për sa kohë ju e pranoni në thelb që Partia Demokratike është e treta, se është fakt ky në rezultatin...

Z. R. Kthupi, përfaqësues i PD-së: Më falni! Pikëpyetja e madhe që shtrohet për zgjidhje është: partia politike në raport me Koalicionin “Bashkë Fitojmë” është subjekti i tretë zgjedhor për shkak të numrit të votave. Problemi është që numri, ose sasia e komisionerëve që caktohen nga partitë politike, varet nga raporti i votave të partive politike dhe koalicionit. Ajo që unë kundërshtoj është logjika me të cilën KQZ-ja merr si të mirqenë që të gjitha votat e koalicionit janë vota të partisë politike. Logjikë e cila për analogji të ligjit, në momentin që do të bëni shpërndarjen e fondeve paszgjedhore, nuk do të ndiqet. Kur të vijë çështja për shpërndarjen e fondeve paszgjedhore, KQZ-ja do të operojë me numërim mandatesh dhe numërim votash. Kjo do të thotë që KQZ-ja në praktikën e saj të punës, pavarësisht se këtu jemi në tërren krejtësisht të ri për shkak të ndryshimeve ligjore... ky është rasti i parë që po

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.19.08.2023*

hasim këtë fenomen dhe hartuesit e Kodit Zgjedhor nuk kanë qenë aq parashikues sa ta merrnin në konsideratë dhe ta rregullonin ligjërisht këtë gjë. Mbetemi te kjo! Çështja është që praktika e mëpasme që do të ndjekë KQZ-ja për shpërndarjen e fondeve, do të operojë mbi bazën e votave të marra nga partia politike, pa i njohur Partisë së Lirisë në rastin konkret si udhëheqëse e koalicionit totalin e vlerës që duhet të marrë financiarisht. Do të jemi në kushtet e dy qëndrimeve të ndryshme me interpretim të të njëjtit ligj. Kur bëhet fjalë për caktimin e komisionerëve të KZAZ-së Partisë së Lirisë do t'i njihet totali i votave të subjektit politik, subjektit zgjedhor "Bashkë Fitojmë". Ndërkohë kur të vijë koha për shpërndarjen e fondeve të KQZ-së do të bëhet një interpretim me numrin e votave individuale të partive politike. Ajo që unë theksoj është që në kontekstin logjik, në interpretimin tërësor të Kodit Zgjedhor, do të duhej që të drejtat e partisë të mos përftojnë dhe të drejtat e subjektit zgjedhor, koalicionit. Do të duhej që Partia e Lirisë të deklaronte, ose të saktësohej në një formë, shuma, sasia e votave që ka. Në raportin krahasues të kësaj sasive votash me sasinë e votave të Partisë Demokratike të saktësohej se kush ishte forca e parë politike që ka të drejtën e propozimit të dy kandidaturave për në KZAZ.

Z. I. Celibashi: Thjesht për dijeninë tuaj, kjo dilemë për ndarjen e fondeve, besoj nuk do të jetë, pasi ata kanë paraqitur një marrëveshje, nqs nuk gaboju unë, edhe për këtë çështje. Të gjitha të drejtat ja kanë kaluar dhe ja njohin Partisë së Lirisë, edhe fondet që do të përfitojnë, nëse nuk gaboju. Gjithsesi argumenti juaj qëndron në një lloj mënyre, por ajo çfarë mbetet në thelb të gjithë këtij debati është fakti që ky si subjekt ka një numër votash të tillë që e bën atë që minimalisht të pretendojë të drejtën për të propozuar anëtarët e KZAZ-së si parti politike e opozitës që ka marrë më shumë vota në zgjedhjet vendore. Ndaj, ne do ta miratojmë projektaktin sipas draftit të propozuar. Natyrisht ju keni të drejtën e ankimit ndaj këtij vendimi në KAS.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.19.08.2023*

Vazhdojmë me procedurën e shortit.

Z. Y. Merkaç: Në enën e parë transparente vendosim dy shirita letre në të cilët janë vendosur emrat e partive politike, Partia Socialiste dhe Partia e Lirisë. Futen në gogla me ngjyrë, peshë dhe formë të njëjtë. Tek ena e dytë transparente janë vendosur dy shirita letre ku është shkruar “numri tek” dhe “numri çift”. Vendosen në gogla me ngjyrë, peshë dhe formë të njëjtë. Në fillim është parashorti ku tërhiqet nga ena e parë emri i partisë që ka të drejtë të tërheqë e para goglën në enën e dytë. Pasi përzihen tërhiqet nga stafi. – Partia Socialiste ka të drejtë të tërheqë goglën në enën e dytë. Meqenëse nuk ka përfaqësues të partisë për të tërhequr goglën, propozohet të autorizohet përfaqësuesi i KQZ-së. Në qoftë se shiriti në goglën që do të tërhiqet në enën e dytë do të jetë “numri tek”, atëherë kjo parti do të ketë dhe anëtarin e shtatë të KZAZ-së nr.11.

Tërhiqet gogla – është “numri tek”. Atëherë sipas procedurës së shortit anëtari i shtatë i KZAZ-së nr.11 do të jetë i Partisë Socialiste, sekretari do të jetë i Partisë së Lirisë. Kryetari i KZAZ-së do të jetë i Partisë Socialiste, ndërsa zv. kryetari do të jetë i Partisë së Lirisë.

Z. I. Celibashi: Mirë atëherë, miratojmë rezultatin e shortit dhe me këtë rast i kemi dhënë fund shqyrtimit të pikës së parë të rendit të ditës.

Vendimi nr. 722

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.19.08.2023*

19.08.2023
Ora 12:28

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për miratimin e formatit dhe specifikimeve të vulës të KZAZ-së, vulës së KQV-së, vulës së kryetarit të KQV-së dhe vulës rezervë të KQV-së, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ:**
 - **Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**
 - **Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja, Z. B. Kodra**
- **Parti Politike: S’ka prezent!**
- **Të tjerë: S’ka prezent!**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës!

Z. Y. Merkaj: Referuar nenit 99 të Kodit Zgjedhor, KQZ-ja dërgon në KZAZ materialet zgjedhore që përdoren nga KZAZ-ja për administrimin e procesit zgjedhor dhe materialet zgjedhore për komisionet e qendrave të votimit. Në to përfshihen edhe vulat e KZAZ-së, KQV-ve dhe kryetarit të KQV-ve, si dhe vulat rezervë për KQV-në. Neni 103, pika 2 e Kodit Zgjedhor përcakton se vula duhet të përmbajë tekstin e mëposhtëm “Komisioni i Qendrës së Votimit”, si dhe numrin përkatës të QV-së. Gjithashtu vula e kryetarit të KQV-së përmban emrin “kryetar” dhe një numër 5-shifror me numër serial. Vula rezervë është tekst unik për secilën vulë që përcaktohet me vendim të Komisionit Rregullator të datës 28.12.2020, me nr. 11 “Për caktimin e rregullave të administrimit dhe shpërndarjes së vulës rezervë të komisionit të qendrave të votimit”. Format i specifikimit të vulave: KZAZ-së,

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.19.08.2023*

KQV-së, të kryetarit të KQV-së dhe vulat rezervë, referojnë përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 390, datë 6.08.1993. Ato prodhohen në Sektorin e Prodhimit të Vulave Zyrtare, pranë Ministrisë së Brendshme me një kosto 1.800 lekë për vulë. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe formatin e specifikimit të vulave të: KZAZ-së, KQV-së, kryetarit të KQV si dhe të vulës rezervë të QV-së. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Mirë atëherë, miratojmë projektvendimin sipas draftit të paraqitur!

Vendimi nr. 723

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.19.08.2023*

**19.08.2023
Ora 12:29**

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për caktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të Komisioneve Zgjedhore të ZAZ-së nr. 11, në zgjedhjet e pjesshme për kryetarin e Bashkisë Kukës, të datës 24.9.2023”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ:**
 - **Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**
 - **Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja, Z. B. Kodra.**
- **Parti Politike: S’ka prezent!**
- **Të tjerë: S’ka prezent!**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës që ka të bëjë me: shpërblimin e anëtarëve të Komisioneve Zgjedhore të ZAZ-së nr. 11.

Z. Y. Merkaj: Referuar nenit 29, pika 3, të Kodit Zgjedhor, KQZ përcakton me vendim masën e shpërblimit për punën që kryejnë anëtarët e komisioneve zgjedhore. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 217, datë 1.12.2022 ka caktuar masën e shpërblimit për komisionerët zgjedhorë për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. KZAZ nr. 11 ka në juridiksionin e saj 73 qendra votimi. Anëtarët e KZAZ-së nr. 11 përfitojnë shpërblim në përputhje me klasifikimin e niveleve të komisioneve të zonave të administrimit të zgjedhjeve të përcaktuara në këtë vendim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. KZAZ-ja nr.11 përfshihet në grupin që kanë në juridiksionin e tyre 50 (pesëdhjetë) deri në 80 (tetëdhjetë) qendra votimi. Komisioneri, për caktimin e masës së shpërblimit të

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.19.08.2023*

anëtarëve të komisioneve zgjedhore, vlerëson kohëzgjatjen e angazhimit, detyrat, përgjegjësitë dhe ngarkesën e punës, sipas nivelit të administratës zgjedhore dhe funksionit përkatës. Duke vlerësuar se angazhimi i kësaj KZAZ-je në raport me periudhën, kushtet dhe volumin e punës korrespondon me 50% të ngarkesës së zakonshme të aktivitetit të KZAZ-së, referuar dhe shpërblimeve kemi parashikuar që të marrin gjysmën e shpërblimit sipas përcaktimit të vendimit nr. 217 të Komisionerit. Shpërblimi do të jetë për:

- Kryetarin dhe zv.kryetari i KZAZ-së në masën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë.
- Sekretari i KZAZ-së në masën 47.500 (dyzetë e shtatë mijë e pesëqind) lekë.
- Anëtari i KZAZ-së në masën 30.000 (tridhjetë mijë) lekë.
- Kryetari i KQV-së në masën 4.000 (katër mijë) lekë.
- Anëtari dhe Sekretari i KQV-së në masën 3.500 (tre mijë e pesëqind) lekë.
- Anëtari i GNV-së në masën 6.000 (gjashtë mijë) lekë.

Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Mirë atëherë, miratojmë projektvendimin sipas draftit të paraqitur me masat e shpërblimit të propozuara.

Çështje të tjera nuk kemi?

Z. Y. Merkaj: Nuk kemi.

Z. I. Celibashi: Mirë, faleminderit! Seanca mbyllet, ditë të mbarë!

Vendimi nr. 724

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

